

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“ARDITI TOURS” shpk**

##### **Neni 1**

##### **FORMIMI**

Sot me date 20.02.2025, **z. ARDIT FAZLIJA**, i datelindjes 12.05.1991, lindur ne Koshare te Kosoves, dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative Farke, Lunder, prane TEG, Tirane, me karte kosovare, ID 2456100, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, bazuar ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.

##### **VENDOSI:**

Te themeloj me vullnetin e tij te lire Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, me emertimin **“ARDITI TOURS” SHPK**

##### **Neni 2**

##### **SELIA**

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **“ARDITI TOURS” SHPK** eshte ne:

**Rruga e Elbasanit, Terminali Lindor i Autobusave, Njesia Administrative Farke, Lunder, pasuria nr. 562/8 zona kadastrale 2529, Tirane.**

**Neni 3**  
**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise “ARDITI TOURS” SHPK eshte pa afat, e pakufizuar.

**Neni 4**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i Veprimtarise se Shoqerise “ARDITI TOURS” SHPK eshte:

Agjensi udhetimi dhe/ose operator turistik, shitblerje pasuri te luajtshme e te paluajtshme, zhdoganim mallrash industriale, bar-kafe restaurant, hoteleri, tregti artikujsh te ndryshem, transport kombetar dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh, import-eksport, shitje online dhe cdo veprimtari tjeter brenda ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, objektin e veprimtarise se saj me vendim te Ortakut te Vetem ose Ortakeve.

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape objekte e njesi sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.

**Neni 5**  
**KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqerise “ARDITI TOURS” SHPK eshte 100,000 (njqind mije) leke, dhe eshte kontribut i ortakut te vetem i barabarte me 1(nje) kuote si me poshte:

**Z. ARDIT FAZLIJA,**

Vlera e kapitalit 100,000 (njqind mije) leke,  
Numri i kuotave 1(nje)  
Pjesemarrja ne perqindje (%) 100

Ai mund te shtohet ose pakesohet me vendim te Ortakut te Vetem ose Ortakeve te Shoqerise.

**Neni 6**  
**ORGANET E SHOQERISE DHE ADMINISTRIMIT**

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise, te cilit i takojne te gjitha kompetencat qe i jepen shoqerise. Vendimet e Asamblese se Ortakeve te shoqerise regjistrohen ne librin e Vendimeve te Shoqerise.

Administratori i shoqërisë është **z. ARDIT FAZLIJA**.

Administratori ushtron funksionin e tij me afat 5-vjeçar, me të drejtë riperteritje.

#### **Neni 7**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT/ ORTAKEVE**

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve, organizimi i shoqërisë, merredheniet me persona fizike e juridike, vendas apo të huaj, shprehen në statut dhe bashkë me Aktin e Themelimit janë dokumente baze të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë fushë.

Te ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë.

Ortakët themelues të shoqërisë kanë të drejtë të emerojnë administratore të tjerë, të caktojnë financiere, likuidatore apo të pranojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiarë për aktivitetin e shoqërisë.

#### **Neni 8**

### **VEPRIMTARIA E SHOQËRISË**

Veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin e hartuar për këtë qëllim.

#### **Neni 9**

### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet midis ortakëve, me persona fizike e juridike, si dhe me organe të shtetërore zgjidhen me mirekuptim, me anë të dispozitave të këtij Akti, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen në rrugë gjyqësore.

#### **Neni 10**

Shoqëria ka vullnet të saj.

**Neni 11**

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“ARDITI TOURS” SHPK** ne Qendren Kombetare te Biznesit Tirane dhe ne kete dite shoqeria njihet si person juridik.

**Neni 12**

Akti i Themelimit u perpilua ne tre origjinale, nga te cilat njera depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe te tjerat ruhen ne dokumentacionin e shoqerise.

Akti i Themelimit nenshkruset rregullisht nga ortakët themelues

Ortakët Themelues te Shoqerise **“ARDITI TOURS” SHPK**

(ORTAK I VETEM)

**ARDIT FAZLIJA**

